

Vendim nr. 70, datë 06.11.2025

(V-70/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 06.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (B) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **BLENDAR BEDINI** *alias* **Imami**, përfaqësuar nga avokat Ardian Visha.

SUBJEKT I INTERESUAR: **PROKURORIA E PËRGJITHSHME**, përfaqësuar nga prokuror Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: **Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.**
Refuzimi i ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini *alias* **Imami nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.**
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimin për lejimin e ekstradimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000**

**“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
(Ligji Organik i Gjykatës).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Bledar Bedini (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pushimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin penal nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali, shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami është deklaruar fajtor për veprën penale “Trafikimi i lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian dhe nenet 73 e 74 të ligjit italian “Për drogën”. Ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane të drejtësisë, mbi bazën e urdhrit për burgosje nr. 57/2009 SIEP, datë 21.09.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali, për ekzekutimin e pjesës së mbetur të dënimit prej 7 vjetësh burgim.

2. Fillimisht, në vitin 2015 autoritetet italiane të drejtësisë kanë kërkuar njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit të lartpërmendur penal të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos, Itali ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami. Bazuar në këtë kërkesë, në datën 22.10.2015 ndaj kërkuarit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”. Paraburgimi i kërkuarit ka vijuar deri në datën 26.10.2016 kur Gjykata e Lartë ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, duke urdhëruar lirin e tij.

3. Në datën 29.12.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur njohjen e vendimit penal të huaj, duke caktuar ndaj kërkuarit një dënim prej 7 vjetësh burgim. Pas gjykimit disa herë të çështjes nga gjykatat më të larta, në rigjykimin e fundit të saj Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 09.07.2019, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrezuar kërkesën e prokurorit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas legjislacionit të brendshëm (shqiptar), referuar nenit 54 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e

huaja në çështjet penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 10193/2009*). Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokurori dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 30.09.2019.

4. Ndërkohë, në datën 15.02.2022 oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer përsëri arrestimin e përkohshëm të kërkuesit, tashmë për qëllime ekstradimi në shtetin italian, bazuar në urdhrin e burgosjes nr. SIEP 57/2009, datë 21.09.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali. Edhe në këtë rast ndaj kërkuesit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”.

5. Në vijim, me kërkesën me Ref: EA 126 (2015) AR, datë 07.03.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë ka kërkuar ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë me vendimin nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Në kërkesë janë parashtruar të dhënat për veprën penale për të cilën është dënuar ky shtetas, cilësimi ligjor i veprës dhe të dhëna rreth vendit dhe kohës së kryerjes së saj (gjatë periudhës 2000-2001). Kërkesa është mbështetur në rregullat e përcaktuara në Konventën Evropiane të Ekstradimit (*KEE*), si dhe në Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e së njëjtës konventë dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, nënshkruar në Tiranë në datën 03.12.2007 (*Marrëveshja e Ekstradimit*). Sipas kërkesës, sistemi juridik italian parashikon se dënimi me burgim parashkruhet me kalimin e një kohe të barabartë me dyfishin e dënimit të dhënë, por, gjithsesi, jo më të madhe se 30 vjet dhe jo më të vogël se 10 vjet.

6. Kërkesën për ekstradim të autoriteteve italiane të drejtësisë, në datën 17.03.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ia ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ia ka dërguar atë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, në datën 18.03.2022, ka paraqitur kërkesë për miratimin e lejimit të ekstradimit të kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 375 akti, datë 14.09.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke miratuar lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë. Në thelb, gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur Republika e Shqipërisë ka ratifikuar KEE-në, sipas së cilës ekstradimi i një shtetasi lejohet në qoftë se dënimi nuk është parashkruar sipas ligjit të shtetit kërkues, duke qenë se dënimi i kërkuesit nuk rezulton të jetë parashkruar sipas ligjit italian, ai (ekstradimi) duhet të lejohet. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1242, datë 20.12.2022, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëruar lirimin e kërkuesit nga paraburgimi. Ajo i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet

e kërkuesit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit sipas ligjit shqiptar, cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të kërkesave të përsëritura (referuar kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj), si dhe për mosdhënien e garancisë nga shteti italian për rishikimin e vendimit penal të huaj, në kushtet kur gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, dënimi me burgim sipas vendimit penal të huaj, për të cilin kërkohet ekstradimi, është parashkruar dhe, bazuar në parimin e reciprocitetit, shteti shqiptar nuk mund të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushte për veprat penale që ka juridiksion. Për sa kohë Italia e ka ratifikuar me rezervë paragrafin 2 të nenit 10 të KEE-së (ndryshuar me protokollin e katërt shtesë), zbatohet parimi i reciprocitetit dhe ajo nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite të k nga një shtet tjetër kontraktues. Për pasojë, duke mos qenë e zbatueshme norma konventore thirret për zbatim ligji i brendshëm, konkretisht neni 491, shkronja “ë”, i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), sipas të cilit parashkrimi i dënimit sipas ligjit të shtetit të kërkuar përbën kusht ndalues për ekstradimin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokurori, me pretendimin se gjykata e apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit, duke parashtruar edhe nevojën për unifikim të praktikës gjyqësore në kushtet e mungesës së harmonizimit mes parashikimeve të KEE-së (nenit 10, paragrafi 2) dhe dispozitave të KPP-së (nenit 491, shkronja “ë”).

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur nisjen e procedurës së gjyqimit për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet: (i) nëse zbatohet nga gjykata parimi i reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore mbi normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti; (ii) nëse gjykata duhet të lejojë ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit shqiptar, drejt një shteti që për shkak të rezervës mbi normën ndërkombëtare refuzon ekstradimin e shtetasve të tij në rrethana analoge kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij. Gjatë shqyrtimit, me vendimin e datës 26.10.2023, ai kolegji ka vendosur pezullimin e gjyqimit të çështjes, duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) të kontrollojë pajtueshmërinë me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës të shkronjës “ë” të nenit 491 të KPP-së, e cila nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Mbledhja e Gjyqtarëve, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, me vendimin nr. 46, datë 12.03.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe në përfundim, me vendimin nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

me të cilin ishte lejuar ekstradimi i kërkuesit në Republikën e Italisë. Ai kolegji ka mbajtur qëndrimin njësoj se gjykata lejon ekstradimin e shtetasve shqiptarë edhe kur ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, duke zbatuar nenin 10, paragrafi 2, të KEE-së, të ndryshuar me protokollin e katërt shtesë të kësaj konvente, edhe në rastet kur një shtet palë ka vendosur rezervë ndaj kësaj norme ndërkombëtare. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 23.10.2024.

10. Ndërkohë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.06.2024, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Nisur nga fakti se kërkuesi nuk ndodhej i burgosur, është kërkuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Interpolit, marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek autoritetet italiane.

11. Në datën 24.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lejuar ekstradimi i tij për në Republikën e Italisë, si dhe refuzimin e ekstradimit. Kjo kërkesë, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.12.2024. Në vijim, në datën 11.03.2025, kërkuesi ka plotësuar ankimin me pretendime shtesë, duke kërkuar edhe pezullimin e vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata, me pretendimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë dhe në zbatim të tij autoritetet shqiptare do të vijonin me ekstradimin e tij, ndaj, në këto kushte, gjykimi i prishëm kushtetues do të zhvishej nga qëllimi dhe roli i tij dhe nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtat e shkelura atij.

12. Kolegji i Gjykatës në datën 12.03.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 18.03.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për pezullimin e vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi për shkak të qëndrimeve të ndryshme, nuk u arrit numri i kërkuar i votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës. Sipas njërit qëndrim, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kërkimi, ka vendosur përfundimisht lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë dhe ky vendim mund të ekzekutohet përpara përfundimit të gjykimit në Gjykatë, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të pranohet¹. Sipas qëndrimit tjetër, duke qenë se ndaj kërkuesit nuk

¹ Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.

po zbatohet asnjë masë sigurimi personal dhe nuk ka një datë të përcaktuar për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkesa për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk duhet të pranohet².

13. Ndërkohë, në datën 16.06.2025 kërkuesi është arrestuar me qëllim ekstradimin e tij, dorëzimin tek autoritetet italiane, sipas aktit miratues të ekstradimit të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë. Në vijim, me kërkesën e kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 969 akti, datë 26.06.2025, ka vendosur lirim të menjëhershëm nga paraburgimi, me arsyetimin se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë në datën 23.06.2025 ka revokuar aktin miratues të ekstradimit për arsye se autoritetet italiane në datën 10.03.2025 kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, në kushtet kur gjykata italiane në datën 11.09.2024 kishte vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian.

14. Në rrethanat si më lart (*shih paragrafin 13 të vendimit*), në çështjen me objekt njohjen e vendimit penal të huaj (*shih paragrafin 3 të vendimit*), Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1183, datë 15.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit, për shkak të heqjes dorë prej tij.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, në kërkesën fillestare dhe atë shtesë, ka parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit cenon:

15.1. *Parimin e mosgjykimit dy herë*, sipas nenit 34 të Kushtetutës (*të parashtruar në ankimin kushtetues të datës 24.12.2024*), për shkak se gjykatat kanë shqyrtuar dhe gjykuar dy kërkesa (njohjen e vendimit të huaj dhe lejimin e ekstradimit) për të njëjtin fakt, ndaj një shtetasi shqiptar, me të njëjtin shtet kërkues. Gjykata e Lartë për të njëjtin fakt që kishte refuzuar njohjen e vendimit dhe ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë, lejoi ekstradimin në kundërshtim me parimet kushtetuese.

15.2. *Parimin e ligjshmërisë*, për shkak se, pavarësisht parashikimeve të nenit 10, paragrafi 2, të KEE-së, sipas të cilit ekstradimi i shtetasve ndalohet vetëm në rastet kur vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese (dhe jo më edhe të asaj të kërkuar), në kushtet

² Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

kur Italia ka vendosur rezervë ndaj parashikimit të këtij neni, në respekt të parimit të reciprocitetit, gjykata në rastin e kërkuarit do të duhej të zbatonte nenin 491, shkronja “ë”, të KPP-së, i cili nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Po ashtu, lejimi i ekstradimit nga Gjykata e Lartë është bërë në kushtet e mungesës së garancisë rishikuese të parashikuar në nenin 491, shkronja “f”, të KKP-së, sipas të cilit ekstradimi nuk mund të jepet kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkuar jep garanci për rishikimin e vendimit.

- 15.3. *Parimin e sovranitetit të shtetit (të parashtruar në ankimin kushtetues shtesë të datës 11.03.2025)*, në kushtet kur lejimi i ekstradimit ka zhveshur shtetin shqiptar nga mbrojtja e shtetasve të tij në një situatë kur nuk ka një detyrim për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare referuar zbatimit të nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së.
- 15.4. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, për shkak se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë, duke i njohur ministrit të Drejtësisë të drejtën të vlerësojë zbatimin e parimit të reciprocitetit, ka zhveshur gjykatat nga kompetenca për të vlerësuar zbatimin e kriterëve dhe kushteve të ekstradimit, në kundërshtim me nenin 39 të Kushtetutës. Po ashtu, ky interpretim i ligjit nga Gjykata e Lartë e ka bërë të paqartë zbatimin e nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së, në shkelje të *parimit të sigurisë juridike*, duke lënë shteg për interpretime dhe zbatim të ndryshëm të tij, në kundërshtim edhe me *parimin e barazisë para ligjit*.
- 15.5. *Parimin e hierarkisë së akteve ligjore*, për shkak të vlerësimit të gabuar të zbatimit ose jo të detyrimeve që rrjedhin nga KEE-ja dhe nga parimi i reciprocitetit.
- 15.6. *Parimin e zbatimit të normës penale favorizuese*, për shkak se në mungesë të një detyrimi për zbatimin e KEE-së nisur nga rezerva e bërë nga shteti italian, neni 419, shkronja “ë”, i KPP-së dhe dispozitat penale shqiptare janë normat juridike të zbatueshme dhe më të favorshme në rastin e kërkuarit, duke pasur parasysh se ato nuk lejojnë ekstradimin kur dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar, i cili parashikon afate më të ulëta për parashkrimin në raport me ato sipas legjislacionit italian.

15.7. *Lirinë personale*, për shkak se ajo është kufizuar pa ligj dhe në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, ndërsa për shkak të procesit të ekstradimit është mbajtur në paraburgim për një periudhë tejet të gjatë, deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë.

16. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se pas depozitimit nga kërkuesi të kërkesës në Gjykatë, Republika e Italisë ka revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, ndërsa në datën 11.03.2025 Ministria e saj e Drejtësisë i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.03.2025, bashkë me njoftimin për urdhrin N.918/2025 SIGE, datë 11.09.2024 të Gjykatës së Apelit të Milanos, e cila ka vendosur shuarjen e dënimit të dhënë ndaj kërkuesit për shkak të parashkrimit, si dhe heqjen e tij nga kërkimi ndërkombëtar, duke i bërë të ditur se nuk kërkon më ekstradimin e tij drejt Italisë. Për rrjedhojë, objekti i kërkesës së kërkuesit është shuar dhe ajo duhet të pushohet.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi në objektin e ankimit të tij ka kundërshtuar: i) vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor; ii) ekstradimin e tij në Republikën e Italisë. Ndërkohë, në përmbajtjen e ankimit shtesë kërkuesi, po ashtu, ka kundërshtuar edhe paraburgimin e tij për qëllime të ekstradimit në Republikën e Italisë, paraburgim ky që është vendosur në një procedurë tjetër të veçantë gjyqësore përmes vendimmarrjeve përkatëse të gjykatave të zakonshme.

19. Duke verifikuar kriteret e legjitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesa të tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të drejtat themelore të tij, çka do të thotë se ai duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në lidhje me kundërshtimin nga kërkuesi të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, si dhe të ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, Gjykata, fillimisht, çmon të evidentojë se ekstradimi jashtë territorit, në kuptim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, rregullohet nga KPP-ja, ndërsa rregullat plotësuese janë parashikuar edhe në ligjin nr. 10193/2009. Sipas këtij kuadri ligjor, procesi i ekstradimit për jashtë shtetit ka natyrë të dyfishtë, duke qenë pjesërisht administrativ për sa i përket veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe pjesërisht gjyqësor, pasi ai mund të lejohet vetëm me vendim gjyqësor, ku në rastin e lejimit është ministri i Drejtësisë ai që disponon përfundimisht për ekstradimin ose jo të një shtetasi.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se autoritetet e drejtësisë italiane kanë paraqitur kërkesë për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, me të cilin ai ishte dënuar me burgim. Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë i ka dhënë rrugë kësaj kërkesë dhe pas kërkesës së prokurorit, në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, me vendimin e kundërshtuar nga kërkuesi, ka vendosur përfundimisht për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.06.2024, ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Megjithatë, ekstradimi i kërkuesit nuk ka ndodhur ndërsa ai ka qenë në gjendje të lirë, ndaj është kërkuar marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek autoritetet italiane. Pikërisht në këtë situatë, përmes ankimit kushtetues individual të kërkuesit, çështja i është paraqitur Gjykatës. Ndërsa ajo ndodhej në pritje për t’u shqyrtuar, Gjykata e Apelit e Milanos, Itali, me urdhrin N. 918/2024, datë 11.09.2024, ka vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian. Nisur nga kjo, me shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.03.2025, autoritetet e drejtësisë italiane kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit

në Republikën e Shqipërisë, duke ua përcjellë atë autoriteteve të drejtësisë shqiptare. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 1034/9 prot.A.H, datë 23.06.2025, ka revokuar aktin miratues të ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Italisë, për shkak të revokimit të kërkesës për ekstradim nga autoritetet italiane në kushtet kur me vendim të gjykatës italiane dënimi me burgim i kërkuesit ishte shuar.

22. Në situatën faktike në momentin e shqyrtimit të çështjes, Gjykata vlerëson se, ndonëse në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe referuar fakteve të bëra asaj prezente kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, ky përfundim nuk mund të qëndrojë në rrethanat aktuale. Në vlerësim të Gjykatës, ky kriter legjitimimi plotësohet vetëm në aspektin procedural, por jo edhe në atë substancial. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se qëllimi i ankimit kushtetues individual dhe interesi i kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit dhe të procesit të ekstradimit është pikërisht garantimi i së drejtës për të mos u ekstraduar. Në rastin konkret, kërkuesi as nuk është ekstraduar dhe aktualisht as nuk ka ndonjë procedurë ekstradimi aktive. Kërkesa për ekstradimin e kërkuesit është revokuar nga autoritetet e drejtësisë italiane dhe nuk ka asnjë masë efektive për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim sipas vendimit penal nr. 2858/2005, datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Për më tepër, dënimi me burgim, që qëndronte në themel të kërkesës për ekstradimin e kërkuesit, tashmë nuk ekziston më, pasi është shuar me vendim të gjykatës italiane. Në këtë kuptim, situata që shkaktoi shkeljen e pretenduar të së drejtës së kërkuesit për të mos u ekstraduar ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme, duke mos pasur më asnjë rrezik për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë me qëllim ekzekutimin e atij dënimi me burgim. Për pasojë, për sa kohë nuk evidentohet që ndonjë aspekt i së drejtës kushtetuese të pretenduar si e shkelur të jetë ende në rrezik, ankimi i kërkuesit ka humbur qëllimin thelbësor, pra mbrojtjen e së drejtës për të mos u ekstraduar dhe, në këtë kuptim, nuk evidentohet pasja nga ai e një interesi substancial. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, si dhe për procesin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë.

23. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë personale, të ngritura në përmbajtjen e ankimit të tij kushtetues individual shtesë, Gjykata vëren se ndonëse legjitimohet *ratione personae*, ankimi i tij nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret kërkuesi ka ngritur pretendime për paraburgimin e zbatuar ndaj

tij, me qëllim ekstradimin në Republikën e Italisë, për periudhën deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë (nr. 1242, datë 20.12.2022), e cila vendosi mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëroi lirimin e tij nga paraburgimi, pra për periudhën 15.02.2022-20.12.2022. Në kushtet kur ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.12.2024, pas më shumë se 2 vjetësh edhe nga heqja e kufizimit të lirisë personale, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është ngritur përtej afatit ligjor 4-mujor, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.11.2025

Shpallur më 27.01.2026